



Deklaratë për shtyp

04.07.2020
Faqja 1 nga 3

**Sekretarja e Shtetit Güler në qarkun e
Gütersloh: „Këtu po ndodhin gjëra
fantastike – por në lidhje me politikën e
integritimit kjo është një shenjë
paralajmëruese.“**

Zyra për shtyp e
kancelarisë së shtetit
40213 Düsseldorf
Telefon 0211 837-1134
0211 837-1405
ose 0211 837-1151

presse@stk.nrw.de

**Qendra e integritimit komunal dhe agjensitë e integritimit
mundësojnë mbështetje veçanërisht për sa i përket mësimit të
gjuhëve gjatë pandemisë së koronavirusit**

**Ministria e Fëmijëve, Familjes, Refugjatëve dhe Integritimit ju
informon:**

Sekretarja e Shtetit e Integritimit, Serap Güler vizitoi qendrën e integritimit komunal dhe të dyja agjensitë e integritimit të DRK-Landesverband Westfalen-Lippe e.V dhe AWO OWL e.V në qarkun e Gütersloh për t'u informuar në lidhje me punën e tyre gjatë shpërthimit të pandemisë të koronavirusit.

Sekretarja e Shtetit Güler: „Mbështetja e shpejtë dhe e pakomplikuar e aktorëve të integritimit komunal në qarkun e Gütersloh për sa i përket përballjes me koronavirusin meriton vlerësim të madh. Jam shumë mirënjohëse për përkushtimin e qendrës së integritimit komunal dhe të agjensive të integritimit të DRK dhe AWO. Kam ndjerë në diskutimet në vend me sa shumë përkushtim tani punonjësit me kohë të plotë dhe vullnetarët janë në gatishmëri të individëve nga Evropa Juglindore. Ky përkushtim është shumë i dobishëm për individët e afektuar tashmë në kohë të vështira. Veçanërisht tani është shumë e rëndësishme që njerëzit të dinë ku mund të marrim informacion dhe ndihmë.“

Qendra e integritimit komunal ka vendosur në dispozicion një linjë telefonike falas për qytetarët nga Bullgaria , Polonia dhe Rumania ku pyetjeve për koronavirusin mund t'u jepet përgjigje në gjuhën amtare.

Kjo përfshin gjithashtu aspekte të ligjit të punës. DRK në qarkun e Gütersloh është veçanërisht e përfshirë në testimin, kujdesin dhe mbështetjen e personave të cilët janë në karantinë. Një detyrë e rëndësishme është gjithashtu përqëndrimi i përkushtimit të vullnetarëve vendas. Agjensia e integritit AWO OWL e.V. po mbështet një fushatë në të cilën individët në karantinë marrin paketa solidariteti. Ata gjithashtu organizojnë fushata për mbledhjen e fondeve për personat e afektuar. Për më tepër, ata po e marrin që tani në konsideratë cilat nevoja mund të lindin pas karantinës në mënyrë që të mundësohen më pas shërbimet e duhura për individët vendas.

Incidenca e infeksionit në industrinë e mishit në qarkun e Gütersloh tregon sërish si kushtet e pasigurta të punës pengojnë integrimin e individëve në shoqëri.

„Ajo që ne po përjetojmë tani rreth evenimenteve tek kompania Tönnies dhe kontraktorëve të saj është shqetësuese dhe tmerrësisht e turpshme. Disa nga punonjësit dhe punonjëset nga e gjithë bota kanë jetuar në izolim dhe pa asnjë kontakt me shoqërinë për shumë vite. Minimumi që mund të bëjmë është t'u kërkojmë kompanive t'u mundësojnë punëtorëve të huaj mësimin e gjuhës dhe pjesëmarrjen në jetën sociale ", sqaroi Sekretarja e Shtetit Güler.

Nordrhein-Westfalen është shteti i vetëm federal në të cilin ka qendra integrimi komunale. 54 ambientet e shtrira në të gjithë republikën ofrojnë shërbime për fëmijët dhe të rinjtë me prejardhje emigrante në mënyrë që të përmirësohen mundësitë e tyre për arsimim. Për më tepër, ata koordinojnë aktivitetet dhe propozimet e komunave dhe të institucioneve sponsorizuese për sa i përket integritit dhe bashkëjetesës me diversitetin. Duke filluar nga 2015 qendrat e integritit komunal mbështesin brenda strukturës së programit të republikës KOMM-AN NRW qytetarë dhe qytetare, të cilët kujdesen për refugjatët në vend. Në një strukturë tjetër e cila është unike në Gjermani, shteti aktualisht po financon 186 agjensi integrimi të sponsorizuara nga Freie Wohlfahrtspflege NRW.

Këto ofrojnë shërbime integrimi në mjedise sociale në të gjithë vendin në përputhje me kërkesën. Agjensitë e integrimit punojnë nga afër me strukturat komunale dhe shërbimet vendase të emigrimit. Nëpërmjet afërsisë së tyre me njerëzit dhe me mjedisin e tyre vendas, ata janë në gjendje të ofrojnë mbështetjen e synuar.

Na ndiqni në internet:

Twitter: [@chancenrw](#)

Facebook: [Chancen NRW](#)

Instagram: [chancenrw](#)

YouTube: [Chancen NRW](#)

Nëse keni pyetje , ju lutemi kontaktoni zyrën e shtypit të Ministrisë së Fëmijëve, Familjes, Refugjatëve dhe Integrimit, Telefon 0211 837-2417.

Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu në dispozicion në internet në adresën e internetit të qeverisë së Republikës [www.land.nrw](#)

[Njoftim për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me rrjetet sociale](#)